



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 507/1 Prot.

Tiranë, më 13 / 4 /2018

V E N D I M

Nr. 104 , Datë 13 / 4 /2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 10, datë 17.01.2018, të paraqitur nga subjekti ankues R.K, kundër F.K¹, M.L², A.D³ dhe B.Gj⁴ në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “moshës”⁵ dhe “aftësisë së kufizuar”⁶. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna, në ankesë, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se: *“Fqinji i tij F.K i ka zaptuar një sipërfaqe toke në pronësi të tij⁷ me pretendimin se i takon atij. Për këtë është ankuar tek administratori i njësisë administrative, M.L, i cili së bashku me topografin e bashkisë B.Gj kanë matur vetëm bazën jugore të tokës pa marrë parasysh hartën kadastrale”*.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin e pronës sipas hartës kadastrale.

Me shkresën nr. 106/2, datë 31.01.2018, Komisioneri ka njoftuar subjektin ankues se nga shqyrtimi paraprak i ankesës, është konstatuar se: Pretendimet e paraqitura nga R.K kundër F.K, nuk mund të shqyrtohen nga Komisioneri, pasi bazuar në nenin 7/1, ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” siguron mbrojtje nga diskriminimi nga: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë⁸ që marrin pjesë në jetën dhe*

¹ Kufitar me pronë e R.K.

² Në cilësinë si, Administrator i Njësisë Administrative Krahës, Memaliaj.

³ Në cilësinë si punonjës i mbrojtjes civile, kadastrës, ujitjes, pyjeve dhe kullotave në Njësinë Administrative Krahës.

⁴ Në cilësinë si topograf pranë Bashkisë Memaliaj.

⁵ R.K, datëlindja 25.03.1941.

⁶ Pajisur me Librezë Verbërie, Grupi II, nr. 07301.

⁷ E vërtetuar me Çertifikatë pronësie, datë 03.09.2007, zona kadastrale nr.3932, numër pasurie 182/20, volumni 2, faqe 81.

⁸ Sipas përcaktimeve të Kodit Civil, neni 24 citon: *“Personat juridikë janë publikë dhe privatë”*.

sektorët publikë⁹ ose privatë¹⁰, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash”. Pra, F.K, në rastin konkret, sipas parashikimeve të bëra në ligj, nuk legjitimohet si subjekt kundër të cilit mund të paraqitet ankesë pranë KMD-së.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi për shkak të moshës dhe aftësië së kufizuar janë shkaqe të mbrojtura nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221/04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Neni 25 përcakton se: “**Personat juridikë publikë** janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik. Institucionet dhe entet shtetërore, që nuk ndjekin qëllime ekonomike, nuk regjistrohen”.

Neni 26 përcakton se: “**Persona juridikë privatë** janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji”.

⁹ **Spektori publik** mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të administratës, ndërmarrjeve publike dhe organizmave publikë të sigurimeve shoqërore.

¹⁰ **Spektori privat** mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të personave juridikë privatë, sipas përcaktimeve të nenit 26, të Kodit Civil.

- Me shkresën Nr.106/1, datë 31.01.2018 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, Njësia Administrative Krahës, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga R.K.

Me shkresën Nr. 24/1, datë 13.02.2018 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Njësia Administrative Krahës, në mes të tjerash informon se: *“Sipas kërkesës së bërë nga R.K, në bashkëpunim me topografin e bashkisë B.GJ, kanë vajtur në vendin për të cilin R.K pretendon se i është pushtuar toka nga F.K. Nga verifikimi i dokumentacionit, të dy palët janë të pajisur me çertifikata pronësie nga ZVRPP Tepelenë dhe të AMTP-ve. Gjatë verifikimit në terren rezultoi se pretendimi i ngritur nga R.K nuk qëndron pasi sipas matjeve nuk kishte cënim të pronës nga F.K”.*

- Me shkresën nr. 106/4, datë 23.02.2018 nga ana e Komisionerit i është kërkuar informacion dhe dokumentacion shtesë subjektit, Njësia Administrative Krahës në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga subjekti ankues.

Me shkresën nr.24/3, datë 07.03.2018 Njësia Administrative Krahës, informon Komisionerin se: *“Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se, R.K është i pajisur me çertifikatë pronësie me nr. Pasurie 182/20 në Z.K = 3932 me sipërfaqe 6020 m² dhe F.K është i pajisur me çertifikatë pronësie me nr. Pasurie 182/21 në Z.K = 3932 me sipërfaqe 3980 m². Nga verifikimi në terren rezulton se nuk ka cënim të pronës së R.K nga ana e F.K. R.K nuk është dakord me verifikimin e kryer nga ana e njësisë administrative”.*

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 56, datë 15.03.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit në Njësinë Administrative Krahës, Bashkia Memaliaj”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë Njësisë Administrative Krahës dhe në Bashkinë Memaliaj më datë 21.03.2018, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit, inspektorët e KMD-s, morën takim me M.L, me detyrë administrator i Njësisë Administrative Krahës, B.GJ, me detyrë punonjës i mbrojtjes civile, kadastrës, ujitjes, pyjeve dhe kullotave në Njësinë Administrative Luftinjë dhe A.D me detyrë punonjës i mbrojtjes civile, kadastrës, ujitjes, pyjeve dhe kullotave në Njësinë Administrative Krahës.

Gjatë inspektimit M.L informoi se: *“Pas administrimit të kërkesës së R.K ka njoftuar Bashkinë Memaliaj të cilët kanë vënë në dispozicion topografin, B.GJ për të kryer verifikimet e ankesës. Së bashku me topografin janë paraqitur pranë pronës dhe janë bërë verifikimet sipas çertifikatës së pronësisë dhe i është komunikuar R.K që nuk ka mbivendosje dhe cënim prone, i cili nuk ra dakord me verifikimin e kryer. Më vonë janë ftuar palët nga Inspektori i policisë së zonës, F.M dhe në prani të administratorit janë ballafaquar palët për konfliktin e pronës dhe në përfundim, përsëri R.K nuk ka rënë dakord me përfundimin e ballafaqimit. Për të dy verifikimet e lartpërmendura nuk është mbajtur procesverbal për arsye se të dy personat janë të pajisur*

çertifikatë pronësie dhe si punonjës të bashkisë nuk kemi kopetencë për zgjidhjen e konflikteve mes banorëve, dhe nëse palët nuk bien dakord me verifikimet e njësisë administrative mund ti drejtohen gjykatës për të zgjidhur konfliktin”.

Gjatë inspektimit B.Gj informoi se: “Gjatë verifikimit të pretendimeve kemi kryer matjet në terren për të përcaktuar kufijtë e pronës sipas hartës treguese të pronës që shoqëron çertifikatën e pronësisë dhe përcakton kufirin ndarës ndërmjet pronave dhe rezultoi se nuk kishte mbivendosje”.

Gjatë inspektimit A.D informoi se: “Pas kërkesës së R.K ka kryer verifikimet e dokumentacionit që disponohet në zyrat e Njësisë Administrative Krahës dhe ZRPP Tepelenë dhe ka rezultuar se nuk ka cënim të pronës të R.K. Ne si kadastër nuk kemi kopetencë për të mbajtur procesverbal kur subjektet janë të pajisur me çertifikatë pronësie, por mbajmë procesverbal kur palët nuk zotërojnë çertifikatë pronësie”.

Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga këqyrja e dokumenteve të vëna në dispozicion nga palët, rezulton se:

- R.K është i pajisur me Çertifikatë për Vërtetim Pronësie datë 03.09.2007, zona kadastrale nr.3932, numër pasurie 182/20, volumi 2, faqe 81.
- F.K është i pajisur me Çertifikatë për Vërtetim Pronësie datë 06.09.2002, zona kadastrale nr.3932, numër pasurie 182/21, volumi 2, faqe 84.

Me shkresën nr.04 datë 08.11.2017, R.K i është drejtuar me kërkesë, Njësisë Administrative Krahës për të kryer verifikimet në lidhje me zaptimin e tokës nga ana e F.K.

Bazuar në kërkesën e R.K, Njësia Administrative Krahës ka marrë masat, ka kryer verifikimin në terren dhe të dokumentacionit dhe në përfundim i ka komunikuar R.K që nuk ka mbivendosje dhe cënim të pronës së tij nga ana e F.K.

Nga vlerësimi i dokumenteve të dorëzuara nga palët, rezulton se ankuesi, ka kërkuar nga Njësia Administrative Krahës, verifikim në lidhje me zaptimin e pronës së tij dhe Administratori i Njësisë si në rastin e verifikimit të pretendimit për cënim të pronës dhe në rastin e ballafaqimit të

palëve në konflikt në prezencën e punonjësit të policisë së zonës ka marrë masat dhe ka ndjekur detyrat si zyrë shërbimi për të gjitha procedurat administrative.

Nga parashtrimi i fakteve dhe shqyrtimi i dokumentacionit të sjellë pranë KMD-së, Komisioneri vlerëson se, nuk ka veprime apo mos veprime nga ana e Njesisë Administrative Krahës në dëm të ankuesit, që të ketë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të pafavorshme, në raport me F.K dhe banorët e tjerë të zonës për shkak të moshës dhe aftësisë së kufizuar. Pra, qëndrimi i Administratorit të Njesisë, M.L dhe B.GJ ka qenë jodiskriminues në drejtim të shqyrtimit të kërkesës së R.K.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak të parashikuara në ligj, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj ankuesit ka një sjellje diskriminuese nga ana e Njesisë Administrative Krahës, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të pretenduar dhe të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹¹ dhe trajtimit të pafavorshëm të ankuesit.

Nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës, dhe shpjegimet e dhëna nga Administratori i Njesisë Administrative Krahës, vlerësohet se kërkesa e R.K është trajtuar me seriozitetin e duhur nga ana e drejtuesve të pushtetit vendor. Pra vlerësohet se nuk ka patur veprime, paragjykitime apo trajtim të pabarabartë për shkak të moshës dhe aftësisë së kufizuar të R.K për më tepër që ankesa e R.K është trajtuar dhe nga operativi i policisë.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se nuk konstatohet trajtim i pabarabartë i ankuesit në raport me banorët e tjerë të zonës nga ana e Administratorit të Njesisë Administrative Krahës, për shkak të moshës dhe aftësisë së kufizuar.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se veprimet e Njesisë Administrative Krahës nuk kanë qenë diskriminuese në drejtim të trajtimit të kërkesës së R.K për shkak të moshës dhe aftësisë së kufizuar.

¹¹ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 2, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit R.K, nga ana e M.L, A.D dhe B.Gj, për shkak të moshës dhe aftësisë së kufizuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(shkaku: mosha, aftësia e kufizuar)
(fusha: te mira dhe sherbime)